


REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

01 Nr. 400/01-55413
Më 18.11.2024



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Nr. Prot.:
Prot. No.: 353/2024
Br. Prot.:
Nr. i faqeve:
No. of pages: -05-
Data:
Date: 15.11.2024
Br. stranice:
Datum:



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Oda e Mjekëve të Kosovës

dhe

Komunës së Drenasit

ODA E MJEKËVE TE KOSOVËS (në vazhdim nën akronim OMK) me seli në adresë QKUK, Instituti A katër III - 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i OMK-ës, Dr. Pleurat Sejdiu Mr.Sci

dhe

KOMUNA E DRENASIT me seli në Rr. Fehmi Lladrovci Drenas 13000, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci

Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjelltë për të siguruar avansimin e personelit mjekësor të Republikës së Kosovës,

Përmes bashkëpunimit të ndërsjelltë në përpunimin e njohurive shkencore dhe praktike të fushën e mjekësisë,

Në mbrojtje të vlerave profesionale dhe integritetit të pozitës së mjekut si profesionist shëndetësor,

Me angazhimin për të dhënë kontributin në forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve në Komunën e Drenasit,

Për veprimet konkrete institucionale për avancimin e kushteve profesionale në ushtrimin të profesionit mjekësor, palët në këtë memorandum dakordohen si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Memorandum synon zhvillimin e bashkëpunimit të ngushtë midis palëve në memorandum, duke u bazuar në funksionet publike dhe shoqërore të palëve.
2. Memorandumi ka për qëllim veçanarisht që të ngritë nivelin e bashkëpunimit të palëve duke marrë parasysh natyriën e veprimitarës dhe aktiviteteve përkthazi me raportin e dyanshëm.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet të përdorura, në kuptimin e këtij Memorandumi kanë këtë domthënie:
 - 1.1. Niveli i kujdesit shëndetësor – nënkuption nivelin e sistemit shëndetësor përkthësish në nivelin parësor;

- 1.2. **Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)** - nënkuption arsimimin dhe edukimin e mjekut me njohuri teorike dhe praktike, të organizuara përmes aktiviteteve të ndryshme profesionale, të cilat mjeku i punësuar në institucionet shëndetësore të nivelit parësor në kuadër të Komunës së Drenasit i vijon gjatë ushtrimit të profesionit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore;
- 1.3. **Fushëveprimi dhe veprimtaria** - nënkupton veprimtarinë e palëve të cilën e ushtrojnë sipas autorizimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi;
- 1.4. **Stafi Mjekësor** - nënkupton të punësuarit në institucionet shëndetësore të nivelit parësor në kuadër të Komunës së Drenasit.

Neni 3

Parimet themelore të bashkëpunimit

1. Zotimet e marra në këtë memorandum palët do të kujdesen që t'i zbatojnë në kauzën e këtij memorandumi duke marrë parasysh parimet e mëposhtme:
 - 1.1 Bashkpunimi dhe bashkëfinancimi me qëllim të avansimit të shërbimeve shëndetësore në nivelin e Kujdesit Primar Shëndetësor për të ofruar shërbime efikase shëndetësore, të integruara dhe të qasshme për të gjithë Komunitetin e Drenasit dhe për një progres të qëndrueshëm në shëndetin publik
 - 1.2 Zhvillimi dhe përparimi i njohurive nga lëmi i mjekësisë për stafin mjekësor të të gjitha institucioneve në nivelin e kujdesit shëndetësor në kuadër të Komunës së Drenasit.
 - 1.3 Organizimin e aktiviteteve me qëllim të edukimin e vazhdueshëm profesional për stafin mjekësor për Zhvillimin Institucional të Kujdesit Parësor Shëndetësor

Neni 4

Fusha e bashkëpunimit

1. Palët dakordohen që me rastin e implementimit të këtij memorandumi që:
 - 1.1. Oda e Mjekëve të Kosovës në kuadër të fushëveprintarisë së vet në mbështetje të Edukit të Vazhdueshëm Profesional, i ofron Komunës, përkatësisht Qendrës së Mjekësisë Familjare në Drenas në mbështetje financiare prej 250 Euro për person pë trajnimin e Stafit Mjekësor: Doktor të Mjekësisë, Specialist të Mjekësisë Familjare përdorimin e Ultrazërit e Abdomenit me qëllim të shërbimeve më efikase shëndetësore. Komuna e Drenasit, në anën tjetër përmes QKMF-së, angazhohet të kontribuojë me një mbështetje financiare prej 250 Euro për peson për grupin e përgjithshëm prej gjashtë (6) mjekëve (gjithsejt 1500 euro) si dhe, Drejtori i QKMF-së, për të trajnuarit me rastin e përfundimit të këtij trajnimi, të dorëzojë palëve një raport të vijueshmërisë dhe vendin e

trajnimit.

- 1.2. Mjetet me nga 50% nga bashkëfinancimi me qëllim të përmisimit të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve të Komunës së Drenasit të realizohet deri më datë 20 Nëntor 2024.
 - 1.3. Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkpunim me Komunën e Drenasit do të bëj planifikimin dhe organizimin dhe përkrahjen e aktiviteteve që kanë për qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional të statit injekesor të punësuar në institucionet të nivelit primar në kuadër të Komunës së Drenasit
 - 1.4. Oda e Mjekëve të Kosovës do të akreditoj dhe vlerësoj me pikë , mjekët pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet e realizuara sipas kriterieve të përcaktuara në Rregulloren për EVP, të cilët janë të punësuar në institucionet e shëndetësore të nivelit primat në kuadër të Komunës së Drenasit.
 - 1.5. Komuna e Drenasit, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë, do të përgadisë raporte vlerësuese për mjekët pjesëmarrës në aktivitetet e realizuara sipas kriterieve të përcaktuara në Rregulloren për EVP, të cilët janë të punësuar në institucionet shëndetësore të nivelit parësore në kuadër të Komunës së Drenasit
2. Palët pas kësaj marrëveshje do të ndërmarrin veprime të përshtatshme për nevojat e cekura më lartë në paragrafin 1 të këtij neni, sipas komunikimit të ndërsjellë.

Neni 5


Mënyra e komunikimit

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'ia komunikojë zyrtarëve të tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuara nga organi kompetent i palës.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejtë si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik.
3. Adresat zyrtate të komunikimit jan:
 - 3.1 Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) – QKUK , Instituti A katër III-10 000 Prishtinë; E-mail: info@omk-rks.org , nr. tel 049 872 300
 - 3.2 Komuna e Drenasit – Rr. Fehmi Lladrovci Drenas 13000, E-mail: komuna.drenas@rks.gov.net

PALËT NËNSHKRUESE

Për Odën e Mjekëve të Kosovës

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci



Për Komunën e Drenasit

Miniz Lladrovci

